



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 1748 prot.

Pukë më, 07, 10, 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr. 3, Date 07/10/ 2025.

PËR

**“EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË PUKË”
NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 47 DATË 17.12.2004, “PËR EMERTIMIN E
RRUGËVE, SHESHEVE DHE INSTITUCIONEVE TË BASHKISË PUKË”**

Në mbështetje të:

- Neni 8 pika 2, neni 9 nënpika 1.7, shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, neni 55 pika 2 e 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar),
- Neni 2 pika 1(ç), neni 3, neni 5 pika 1, neni 7, neni 25 e 26, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 “për sistemin e adresave” (i ndryshuar),
- Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar),
- VKB-në nr.47 datë 17.12.2004 “Për emertimin e rrugëve, shesheve dhe institucioneve të bashkisë Pukë”
- Si dhe në relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë në mbledhjen e datës _____/10/2025, me propozim të kryetarit të bashkisë Këshilli i Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë emërtimin e rrugës nga këndi i njoftimeve në qendër deri te Xhamia e qytetit Pukë, me emrin **“Rruga e Xhamisë”**, sipas planvendosjes bashkëlidhur
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Pukë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”

Hartuesi

Drejtorja e Plan. të territorit
Ing.Lindita Hyseni

Juristi
Aida Sinani

KRYETARI
RROK DODAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Prot. 1748/1

08.07.10.2025

RELACION

MBI PROJEKT VENDIMIN PËR “EMËRTIM RRUGE NË TERRITORIN E BASHKISË
PUKË”

PËR KËSHILLIN BASHKIAK
Pukë me 07.10.2025

Të nderuar këshilltarë !

Ky projekt vendim është hartuar duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 8, neni 9/1, pika 1.1/b, pika 2, 9, neni 54 pika 11, neni 55 pika 2, si dhe në Kërkesën nr.57 prot, datë 08.10.2024, protokolluar në Bashkinë Pukë me nr. 1909 Prot, datë 11.10.2024, dokumentat e paraqitura përmes shkresës nr.83 Prot, datë 16.09.2025, protokolluar në Bashkinë Pukë me nr. 1704/2 Prot, datë 17.09.2025, nga Myftinia Pukë,

Administrata e bashkisë propozon që këshilli i Bashkisë Pukë të miratojë emërtimin e rrugës **nga këndi i njoftimeve në qendër deri te Xhamia e qytetit Pukë, me emrin “Rruga e Xhamisë”, sipas planvendosjes bashkëlidhur**

Bashkëngjitur:

1. Pozicionimi sipas Hartës nga Gjeoportali Shtetëror ASIG,
2. Kërkesa dhe informacioni përkatës të depozituara pranë bashkisë Pukë,

Konspektoi: ing. L. Hyseni

KRYETARI

RROK DODAJ



Plani i vendosjes së rrugës që do emertohet “Rruga e Xhamisë”

